

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË	 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E PEJË ZYRA E KRUVETARIT / URED PREDSEDNIKA	
REKTORATI		Nr./Br. <u>025</u> Nr.faq/Br. str. <u>2KH</u>	
Str. No. <u>1628</u> Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>3</u>	Data/Datum. <u>23/06/23</u>		
Data/Datum / Date: <u>23/06/2023</u> Pejë / Poë	BURE/PEÇ		

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

Universitetit "Haxhi Zeka", me seli në Pejë, Rr. UÇK-së, pn.

Dhe

Komunës së Pejës, në Rr. Hasan Prishtina, Pejë

Në mbështetje të koncept dokumentin për Krijimin e Forumit Ekonomik Rajonal "Dukagjini", palët nënshkruese të këtij memorandumi akordohen si në vijim:

### Hyrja

1. Palët i njohin vlerën dhe rëndësinë e bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik dhe akademik të rajonit Dukagjini.
2. Palët pajtohen për të ndërtuar dhe zhvilluar Forumin Ekonomik Rajonal "Dukagjini" (FERD), si një platformë të përbashkët për të promovuar dhe ndihmuar në zhvillimin ekonomik të rajonit.
3. Palët pajtohen që të gjitha, objektivat, qëllimet, aktivitetet e forumit ekonomik rajonal dukagjini, të parapara në koncept dokumentin, do të zhvillohen dhe implementohen përmes Organizatës Jo qeveritare të themeluar nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë me të njëjtin emër "*Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini (FERD)*"

### Objektivat

1. Palët si objektiv themelor kanë promovimin, zhvillimin ekonomik, akademik dhe social të rajonit.
2. Palët synojnë të promovojnë bashkëpunimin mes Universitetit Haxhi Zeka, Komunës së Pejës, dhe partnereve tjerë, nëpërmjet FERD, për të identifikuar dhe zhvilluar projekte, trajnime, programe dhe inovacione që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe akademike të rajonit.
3. Nxitja e dialogut ndër rajonal me qëllim promovimin e politikave ekonomike, vlerave sociale, politike dhe kulturore;
4. Bashkëpunimi rajonal në drejtim të koordinimit të projekteve investive me interes për rajonin e më gjerë;
5. Organizimi i Forumit ekonomike, sociale, akademike, biznesore, politike me partneritet publiko-privat;
6. Ofrimi dhe avancimi i ideve novatore që çojnë në hartimin e projekteve investive, me synimpërfshirjen dhe mobilizimin e kapitalit të diasporës dhe me gjere.

7. Inkurajimi dhe nxitja e investimeve të huaja direkte dhe përmirësimi i klimës për të bërë biznesë në rajonin e dukagjinit dhe me gjere.
8. Aplikimin e përbashkët dhe hartimin e projekteve për zhvillim ekonomik të rajonit në organizata, institucione, lokale, rajonale dhe ndërkombëtare etj.

### Përmbajtja e bashkëpunimit

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në të gjitha aspektet që lidhen me organizimin e Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini.
2. Palët marrin përsipër të organizojnë takime periodike të Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini, të cilat do të përfshijnë prezantime, diskutime dhe aktivitete të ndryshme për të promovuar zhvillimin ekonomik të rajonit.
3. UHZ, do të bashkëpunoj me Komunën e Pejës për identifikimin e nevojave për trajnime dhe për të siguruar trajnime të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e FERD, për zhvillimin Ekonomik të Rajonit.
4. UHZ, Komuna e Pejës, dhe komunat e tjera si dhe partnerët tjerë, fillimisht do të ndaj një fond për Forumin Ekonomik Rajonal Dukagjini, për trajnimin e stafit të FERD, stafin e UHZ-së dhe ekspertët tjerë që angazhohen nga partnerët e këtij forumi lidhur me shkrimin, aplikimin në projekte të përbashkëta që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik, akademik të rajonit.
5. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në hartimin e strategjive të përbashkëta, projekteve dhe programeve që kanë për qëllim investimet që përmirësojnë kualitetin e arsimit, inovacionin, trajnimin e stafit dhe rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike të rajonit.

### Organizimi i Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini

1. Palët përcaktojnë se Forumi Ekonomik Rajonal "Dukagjini" do të organizohet së paku një herë në vit në një vendndodhje të përcaktuar nga Palët.
2. Palët pajtohen se organizimi i parë i Forumit Ekonomik Rajonal "Dukagjini" do të bëhet nga UHZ, duke siguruar infrastrukturën dhe burimet e nevojshme për zhvillimin e suksesshëm të takimit.
3. Palët angazhohen të mbajnë takime të rregullta në nivel teknik dhe koordinim për të përgatitur dhe monitoruar zhvillimin e Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini. Këto takime do të përfshijnë përfaqësues nga Universiteti Haxhi Zeka dhe Komuna e Pejës, komunat tjera dhe partneret tjerë që janë pjesë e këtij forumi, për të diskutuar dhe koordinuar çështjet që lidhen me organizimin dhe përparimin e Forumit.
4. Të gjitha komunat, bizneset dhe organizatat tjera partnere të këtij forumi do të caktojnë nga një përfaqësues si pjesë e forumit, përfaqësuesit nga komunat do të emërohen nga kryetarët e komunave.
5. Organizatës Jo qeveritare e themeluar nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë "**Forumit Ekonomik Rajonal "Dukagjini" (FERD)**", sipas koncept dokumentet i cili është bazë për nënshkrimin e këtij memorandumi, do t'i implementoj të gjitha aktivitetet e përbashkëta të partnereve, duke përfshirë edhe organizimin e takimeve të rregullta.

6. Palët shprehin gatishmërinë e tyre për të inkurajuar pjesëmarrjen e institucioneve akademike, sektorit privat, organizatave joqeveritare dhe autoriteteve vendore të rajonit në Forumin Ekonomik Rajonal Dukagjini. Përmes kësaj, synohet të krijohet një rrjet i gjerë bashkëpunimi dhe shkëmbimi të idesë dhe njohurive.
7. UHZ, do të ofrojë të gjithë infrastrukturën për Forumin Ekonomik Rajonal Dukagjini, si objekte, zyra, Stafin, që të implementohen të gjitha aktivitetet, projektet e përbashkëta për zhvillimin ekonomik rajonal.

#### Avancimi i Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini

1. Palët shprehin përkushtimin e tyre për të ndjekur dhe monitoruar avancimin e Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini, si dhe për të vlerësuar efektshmërinë dhe arritjet e tij në realizimin e objektivave të përcaktuara.
2. Palët kanë për qëllim të përcaktojnë ndikimin e Forumit në zhvillimin ekonomik dhe akademik të rajonit, duke zhvilluar një mekanizëm të vlerësimit të rezultateve dhe efektit të realizuar.
3. Palët pajtohen të bëjnë një raport të rregullt të avancimit të Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini, që do të përfshijë analizën e arritjeve, sfidat dhe rekomandimet për të përmirësuar funksionimin e tij në të ardhmen.

#### Zbatimi dhe Ndryshimi i Memorandumit

1. Palët angazhohen të zbatojnë me përkushtim dispozitat e këtij Memorandumi dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara në koncept dokumentin.
2. Ky Memorandum përfaqëson marrëveshje midis Universitetit Haxhi Zeka dhe Komunës së Pejës lidhur me bashkëpunimin dhe mbështetjen në organizimin dhe zhvillimin e Forumit Ekonomik Rajonal Dukagjini.
3. Ky Memorandum është i nënshkruar në dy kopje të njëjta, ku secila palë do të mbaje nga një kopje.
4. Memorandumi do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe do të zbatohet në përputhje me dispozitat dhe kushtet e saj, dhe vazhdon të jetë në fuqi për një periudhë të caktuar prej 5 viteve.
5. Ndryshimet apo amandamentimet në këtë Memorandum mund të bëhen nëpërmjet një marrëveshjeje të shkruar midis Palëve, të cilat do të jenë të vlefshme vetëm pas nënshkrimit të tyre.

Prof.dr. Armand Krasniqi  
Rektor i UHZ-së



Z. Gazmend Muhaxheri  
Kryetar i Komunës së Pejës

